

MENDIM PAKICE

Unë, Pamela Qirko, në cilësinë e Kryesueses, nuk isha dakord me vendimin e shumicës së trupit gjykues për subjektin e rivlerësimit Blerina Muço dhe votova kundër sepse mendoj se vlerësimi i provave dhe fakteve nuk është i bazuar në ligj, në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe standardin e Komisionit. Për këtë arsye, kam votuar për konfirmimin në detyrë të subjektit. Ky vlerësim i imi bazohet në analizën e mëposhtme:

1. Në lidhje me apartamentin me sip. 151 m2, blerë nga subjekti dhe bashkëshorti i saj në vitin 2000.

Ndryshe nga sa shumica konkludon në lidhje me kredinë që ka shërbyer si burim për blerjen e pasurisë, unë mendoj se parashikimet e VKM-së nr. 102/1999 janë të qarta dhe e shkarkojnë krejtësisht subjektin nga barra e provës. Nënshkrimi i kontratës së shitblerjes si kusht për lëvrimin e kredisë është qartësisht një kusht i paracaktuar me VKM, për pasojë subjekti nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi dhe të ndëshkohet për këtë.

Nga ana tjetër, konstatohet se në kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 24.06.2000, parashikohet se pagesa do të kryhet në arkën e shoqërisë nëpërmjet kredisë që bashkëshorti i subjektit do të merrte në Bankën e Kursimeve. Pagesa e këtij apartamenti me kredinë e marrë në Bankën e Kursimeve, sot Raiffeisen Bank, provohet dhe me shkresë nr. *** prot., datë 15.11.2018 të kësaj banke, e cila ka vënë në dispozicion dhe mandatin e pagesës të datës 12.10.2000. Për rrjedhojë, vlerësoj se nga ana e subjektit është provuar kryerja e pagesës, pasi është lidhur kontrata e shitblerjes.

Në lidhje me konfliktin e interesit me shoqërinë ***, do të shprehem në vijim.

2. Në lidhje me detyrimin e pagimit të vlerës së doganës të automjetit me targë TR*.**

Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se, me anë të kontratës së Shitblerjes automjeti me nr. ***, dt. 4.11.2004, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. M.M, ka blerë automjetin tip ***, në vlerën 700,000 lekë. Ky automjet rezulton të jetë blerë gjatë kohës që ai ka qënë deputet i Kuvendit të Shqipërisë. Në këto kushte, ndryshe nga shumica, vlerësoj se bashkëshorti i subjektit ka qënë i përjashtuar nga ky detyrim bazuar në nenin 17 të Ligjit nr.8550, datë 18.11.1999 “Statusi i deputetit”, ku parashikohet se: *Deputetit i lejohet që vetëm në një rast gjatë mandatit të tij të mos paguaj detyrim doganor për mjetet e punës, që lidhen me veprimtarinë e tij si deputet.*

Nga hetimi ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit gjatë periudhës që ka patur mandatin e deputetit, por dhe në vijim ka blerë vetëm këtë automjet.

3. Në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga *** sh.p.k

3.1 Fillimisht konstatoj se, në analizën financiare të kryer për subjektin është përfshirë gjendja e llogarisë bankare, në të cilën kanë kaluar këto të ardhura, të cilat sipas vlerësimit të shumicës janë konsideruar si të paligjshme.

Nëse këto të ardhura do të konsiderohen si jo të ligjshme, pasi nuk janë paguar detyrimet tatimore, atëherë rrjedhimisht në analizë financiare nuk duhet të përfshihet dhe llogaria ku janë transferuar këto shuma. Komisioni i ka përfshirë në analizë financiare gjendjet e llogarive, ndërkohë që shumat e transferuara në këto llogari nuk i ka përfshirë, duke rënduar pa të drejtë në këtë mënyrë pozitën e subjektit.

3.2 Së dyti, kam votuar që këto të ardhura duhet të konsiderohet si të ligjshme, pasi:

- a. Shumat janë transferuar në llogarinë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në Intesa San Paolo Bank në vlerat si më poshtë:
 - *Viti 2005 shuma 6000 euro*
 - *Viti 2006 shuma 26980 euro*
 - *Viti 2007 shuma 26100 euro*
 - *Viti 2008 shuma 2000 euro*
 - *Viti 2009 shuma 12000 euro*
 - *Viti 2010 shuma 7000 euro*

Pra, në total për vitet 2005-2010 rezulton se bashkëshortit të subjektit i është depozituar shuma 80.080 euro. Këto shuma fillimisht janë investuar në depozita në vlerën 50.000 euro, shumë e cila është tërhequr në vitin 2008 nga bashkëshorti i subjektit dhe është deklaruar si kursim cash në vlerën 47.000 euro. Në vitin 2010 është krijuar një depozitë tjetër në vlerën 27.000 euro, e cila ka vijuar dhe në deklaratën Vetting.

- b. Në lidhje me këto shuma, gjatë hetimit është provuar që ato rrjedhin nga marrëveshja e bashkëpunimit e bashkëshortit të subjektit në shoqërinë *** sh.p.k dhe më pas ***.

3.3 Subjekti gjatë hetimit ka depozituar:

- ***Marrëveshje bashkëpunimi lidhur midis bashkëshortit të saj dhe shoqërisë *** sh.p.k në datë 15.08.2005.***
- Marrëveshja ka të gjitha ekstremitet e kërkuara nga legjislacioni në fuqi¹, ajo është e sigluar në çdo faqe, si dhe në faqen e fundit është firmosur nga z. E.B, administrator i shoqërisë, si dhe është vulosur me vulën e shoqërisë.

¹ Referuar Kodit të Punës por dhe Kodit Civil kontratat e punës për efekt vlefshmërie apo provueshmërie nuk janë të detyrueshme për t'u bërë me akt noterial. I njëjti qëndrim në lidhje me vlefshmërinë e kontratave është mbajtur nga Kolegji i Posaccëm i Apelit në vendimin nr. 26/2023 paragrafi 14.24

Në këtë marrëveshje parashikohet se bashkëshorti i subjektit do të ofrojë shërbime ligjore dhe se shpërblimi vjetor i tij do të jetë rreth 24.000 euro, afati i saj do të jetë tre vjeçar dhe në pikën 7 të saj parashikohet se detyrimet tatimore do të paguhen nga shoqëria.

- ***Të gjitha mandat pagesat e kryera nga shoqëria *** sh.p.k., të cilat janë bërë nëpërmjet sistemit bankar.***

Rezulton e provuar se bashkëshorti i subjektit ka patur rolin e konsulentit (duke ofruar shërbime ligjore) pranë shoqërisë *** sh.p.k, si dhe është paguar rregullisht nga kjo shoqëri nëpërmjet sistemit bankar që në momentin e lidhjes së marrëveshjes në vitin 2005. Bazuar në gjendjen e llogarisë bankare të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në Intesa San Paolo Bank, si dhe në mandat pagesat e depozituara nga subjekti, rezulton se në total gjatë periudhës 2005-2010, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit i është depozituar shuma 73.000 euro, shumë kjo që përputhet me parashikimet e marrëveshjes së bashkëpunimit.

3.4 Duke iu referuar marrëveshjes së bashkëpunimit rezulton që kemi të bëjmë me një marrëdhënie shërbimi konsulence/porosie². Në lidhje me këto shërbime parashikohet vetëm pagesa e tatimit në burim. Bazuar në legjislacionin tatimor, detyrimin për të paguar detyrimet tatimore, që rrjedhin nga kjo kontratë, e ka pasur shoqëria *** sh.p.k/***.

Më konkretisht në nenin 10 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar parashikohet se: *Çdo punëdhënës, që paguan një pagë a shpërblim të parashikuar në gërmën “a”, të nenit 8 të këtij ligji, mban tatimin mbi të ardhurat personale, në përputhje me paragrafin e parë, të nenit 9 të këtij ligji dhe e derdh tatimin e mbajtur në favor të organeve tatimore, jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës.*

3.5 Në lidhje me këto të ardhura bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit rezulton se:

- i. Subjekti ka provuar ekzistencën e vazhdueshme të marrëdhënies së shërbimit të konsulencës mes personit të lidhur dhe shoqërisë *** shpk, në kushtet kur, bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ u provua puna konkrete/përgjegjësitë e personit të lidhur, në kuadër të rregullave dhe organizimit të shoqërisë;
- ii. deklarimi i të ardhurave të përfituara nga shërbimi në shoqërinë *** Shpk, nuk është një deklaram i posaçëm i kryer nga subjekti i rivlerësimit vetëm në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, por ka qenë një deklaram i bërë rregullisht, në deklaratat periodike vjetore, duke filluar nga viti 2005 kur është lidhur marrëveshja e bashkëpunimit midis bashkëshortit të subjektit dhe shoqërisë.
- iii. Të gjitha pagesat provohen se janë kryer nëpërmjet sistemit bankar dhe asnjë prej tyre nuk është marrë cash, për rrjedhojë provohet dhe:

² Në pikën 3 të kësaj marrëveshje referohet në nenin 913 të K.Civil

- iv. Mungesa e dijenisë së personit të lidhur për mospërbushjen nga shoqëria të pagesës së detyrimeve tatimore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, sipas parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, e cila e përjashton atë nga të qenit në kushtet e keqbesimit në raport me sjelljen e palës marrëse të shërbimit.

3.6 Ndërsa sa i takon vlerësimin të ligjshmërisë së këtyre të ardhurave, në kuadër të standardit të vendosur nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit³, vlerësoj se, pavarësisht se nga hetimi rezultoi që për të ardhurat e krijuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk janë përmbushur detyrimet tatimore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, fakti që ky detyrim, referuar parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, bie mbi shoqërinë *** sh.p.k, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, nuk mund të penalizohen në kuadër të procesit të rivlerësimit, në drejtim të vlerësimit të ligjshmërisë së të ardhurave të realizuara nga shërbimi i konsulencës, për sa kohë nuk provohet që mospërbushja e detyrimeve të palës *** sh.p.k ka qenë e ditur dhe, rrjedhimisht, e pranuar nga bashkëshorti i subjektit.

3.7 Në kuadër të vlerësimit të qenies apo jo në mirëbesim, lidhur me pagesat e detyrimeve që lindin nga marrëveshja kam mbajtur në konsideratë faktin që pagesat janë kryer në tërësinë e tyre, në masën e pretenduar, nëpërmjet sistemit bankar, ç’ka vlerësohet se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit nuk ka qenë në kushtet për të vënë në dyshim se lidhur me pagesat e përfituara, nuk ishin shlyer nga shoqëria detyrimet me natyrë tatimore ndaj shtetit. Gjithashtu, në kuadër të kësaj analize, kam mbajtur në konsideratë edhe kërkesëpadinë e ngritur me objekt përmbushjen e detyrimeve tatimore ndaj organeve shtetërore kompetente, duke konfirmuar në këtë drejtim bindjen se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, nuk ka qenë në keqbesim në raport me sjelljen e shoqërisë *** sh.p.k.

3.8 Në përfundim, ndryshe nga shumica vlerësoj se shuma 73.000 euro duhet të përfshihet në analizë financiare përkatësisht:

- Viti 2005 shuma 6000 euro
- Viti 2006 shuma 24000 euro
- Viti 2007 shuma 22000 euro
- Viti 2008 shuma 2000 euro
- Viti 2009 shuma 12000 euro
- Viti 2010 shuma 7000 euro

³ Shih vendimet e Kolegjit nr. (JR) 15/2021, datë 18.06.2021; nr. (JR) 35/2022, datë 22.09.2022; nr.(JR) 4/2023; nr.(JR) 26/2023

4. Në lidhje me analizën financiare

Në përfundim, në lidhje me kriterin e pasurisë, nga analiza financiare e kryer, duke përfshirë shumën 73.000 euro, subjekti rezulton me një rezultat negativ për periudhën 2003-2016 në shumën 913,760 lekë. Referuar Jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit kjo mungesë burimesh financiare nuk mund të konsiderohet si deklaram i pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

5. Lidhur me pasaktësitë në deklaratat periodike

Në këndvështrimin tim, bazuar në qëndrimin e mbajtur nga Kolegji në çështje të ngjashme, e cila përbën tashmë jurisprudence të konsoliduar të tij⁴, vlerësoj se një deklaram i pasaktë në deklaramet e mëparshme periodike të interesave nuk mund të konsiderohet se është bërë në kundërshtim me përcaktimin e germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë, nuk është element i mjaftueshëm për t’u konsideruar si një shkak i vetëm dhe i veçuar që prodhon situatën e deklaramit të pamjaftueshëm, në kuptim të pikës 3 të nenit 61 të këtij ligji.

6. Në lidhje me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale.

Vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues. Pavarësisht nga ky konstatim, bie dakord me shumicën se sjellja e subjektit të rivlerësimit në disa raste nuk ka qenë në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, lidhur me aftësitë organizative të një gjyqtari. Problematikat e konstatuara në gjykimin tim, nuk ngrihen në nivelin e shkakut që e bëjnë subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm në kuptim të nenit 44, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, për të justifikuar vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 4 e këtij ligji apo të konsiderohet në vlerësimin tërësor të procedurave.

7. Në lidhje me përdorimin e mbiemrit Muça

Në këndvështrimin tim, vlerësoj se ky veprim i saj nuk përbën shkelje të ligjit apo cënim të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë.

Është e vërtetë që në disa raste subjekti nuk ka përdorur mbiemrin e saj, sipas gjendjes civile, duke mos treguar kujdesin e nevojshëm, por nuk është konstatuar asnjë rast kur vendimet e saj të jenë cënuar nga gjykatat më të larta për këtë shkak, si dhe nuk ka rezultuar asnjë rast i cënimit të të drejtave të palëve në gjykim. Gjithashtu në asnjë dispozitë (nenet 101-104) të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk parashikohet si shkelje disiplinore përdorimi në mënyrë të gabuar i prapashtesave të mbiemrit, për rrjedhojë vlerësoj se kjo pakujdesi nuk mund të konsiderohet si arsye apo të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra e aq më tepër si cënim i besimit të publikut tek drejtësia.

⁴ Vendimet nr. 9/2020 (JR), datë 26.6.2020, nr. 16/2020 (JR), datë 13.7.2020; nr. 31/2020 (JR), datë 18.11.2020, dhe nr. 26/2023(JR) datë 03.07.2023 të Kolegjit.

Ky qëndrim imi bazohet dhe në një rast të ngjashëm (vendim nr.293/2020) ku 2/3 e kësaj trupe, anëtarë të asaj trupe pasi e kanë diskutuar, kanë vlerësuar se nuk ka qënë e nevojshme as që subjektit t'i kalohet barrë prove për përdorimin e ndryshëm të mbiemrit.

8. Në lidhje me konfliktin e interesit

Si komisionere e mbetur në pakicë, vlerësoj se subjektit në asnjë rast nuk ka qënë në kushtet e konfliktit të interesit.

8.1 Nga hetimi ka rezultuar se:

- a. Bashkëshorti i subjektit ka lidhur kontratë shitblerje me shoqërinë *** më datë **24.06.2000**;
- b. Subjekti ka gjykuar çështje gjyqësore më palë shoqërinë e ndërtimit/ortakun e saj në periudhat **2007-2018**;
- c. Bashkëshorti i subjektit ka qënë në marrëdhënie punë me shoqërinë *** sh.p.k për një periudhë 3 vjeçare **2005-2008**, ndërkohë që pagesat kanë vijuar deri në vitin **2010**;
- d. Subjekti ka gjykuar çështje gjyqësore me palë shoqërinë *** sh.p.k në periudhën **2013-2017**;
- e. Bashkëshorti i subjektit ka qënë në marrëdhënie punë me shoqërinë *** në vitin 2013;
- f. Subjekti ka në gjykim aktualisht dy çështje me palë shoqërinë ***;
- g. Bashkëshorti i subjektit ka qënë në marrëdhënie punë me shoqërinë *** gjatë vitit 2015-2016;
- h. Subjekti ka në gjykim aktualisht një çështje me palë shoqërinë ***.

8.2 Bazuar në të dhënat e mësipërme, konstatohet se subjekti nuk ka gjykuar asnjë çështje në periudhën që bashkëshorti i saj ka qënë në një marrëdhënie interesi me shoqëritë e mësipërme. Ajo ka gjykuar ose po gjykon çështje gjyqësore me palë shoqëritë e mësipërme, pasi ka kaluar një periudhë më shumë se 7-vjeçare.

8.3 Vlerësoj se konflikti i interesit duhet të trajtohet në raport me dispozitat e ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe të Kodit të Procedurës Civile, të cilat përcaktojnë kushtet dhe procedurat për deklarimin dhe shmangien e konfliktit të interesit të gjyqtarëve, si dhe të heqjes dorë nga shqyrtimi i çështjes. Në nenin 3, pikat 1 dhe 4 të ligjit 9367, parashikohet se: 1. “Konflikt i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisive të tij publike [...] 4/b) “konflikt në dukje i interesit” është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësisive të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë [...]. Ndërsa në nenin 13 të këtij ligji parashikohet se: 2. Për proceset gjyqësore dhe hetimet parlamentare, identifikimi dhe regjistrimi i interesave, sipas këtij kreu, bëhen vetëm për ato veprime, që kryhen para dhe jashtë një procesi konkret gjyqësor civil, një

procedimi penal ose hetimi parlamentar. Brenda këtij procesi, identifikimi dhe regjistrimi i interesave kryhen sipas rregullave të përcaktuara, sipas rastit, në kodet e procedurave civile dhe penale, si dhe të legjislacionit që rregullon procesin e hetimit parlamentar. Ndërkohë, Kodi i Procedurës Civile, në nenin 72 përcakton se: Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete [...] 6) në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie.

8.4 Në rastin konkret, vërej se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka pasur marrëdhënie interesi me: (i) shoqërinë *** në vitin 2000, e cili ka përfunduar po në këtë vit, ndërkohë subjekti ka gjykuar çështje me palë këtë shoqëri për periudhën 2007-2018, pra pas 7 viteve lidhje e kontratës së shitblerjes; (ii) me shoqërinë *** sh.p.k në vitin 2005, e cila ka përfunduar në vitin 2008 dhe shlyerja e detyrimeve në vitin 2010, ndërkohë subjekti ka gjykuar çështje me palë këtë shoqëri për periudhën 2013-2017, pra pas 5 viteve nga përfundimi i marrëdhënies së punës dhe pas 3 viteve nga kryerja e pagesës së fundit; (iii) me *** në vitin 2013 dhe ka përfunduar në këtë vit; (iv) me shoqërinë *** në vitin 2015, e cila ka përfunduar në vitin 2016. Në lidhje me këto dy të fundit subjekti provoi që ka hequr dorë nga shqyrtimi i çështjeve në gjykim.

8.5 Sikundër rezulton gjykimi i çështjeve nga subjekti i rivlerësimit është zhvilluar disa vite pasi kushtet e marrëdhënies së interesit ishin vendosur, jashtë çdo ndikimi të mundshëm ndaj ndonjë interesi të subjektit. Nisur nga të dhënat e mësipërme, në mungesë të rrethanave që dëshmojnë ndonjë interes pasuror nga subjekti në kushtet e konfliktit, vlerësoj se rrethanat e përshkruara nuk mund të konsiderohen si shkaqe të rëndësishme njëanshmërie, në kuptim të nenit 72 të Kodit të Procedurës Penale, që do të sillnin detyrimin e subjektit të rivlerësimit për të hequr dorë nga shqyrtimi i çështjes gjyqësore dhe, për pasojë, konkluzioni i shumicës se kjo rrethanë duhet konsideruar si një shkak për vendosjen e masës disiplinore ndaj subjektit, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, gjendet i pabazuar në prova e në ligj. Ky konkluzioin mbështet dhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit⁵.

9. Lidhur me cënimin e besimit të publikut.

Në lidhje me cënimin e besimit të publikut duke marrë në konsideratë qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e kolegjit, se analiza e të dhënave që rezultojnë vetëm nga një prej kriterëve të rivlerësimit, përveç rasteve tepër specifike, nuk mund të shërbejë në funksion të analizimit të përgjithshëm të tri kriterëve sipas nenit 2, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i cili kërkon që të vlerësohen në harmoni të dhënat që burojnë nga vlerësimi i tri kriterëve të rivlerësimit, për të konkluduar eventualisht për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë çmoj se problematika që kanë shoqëruar punën e gjyqtarës, për sa kohë që nuk konsiderohen të mjaftueshme për ta kualifikuar subjektin e rivlerësimit, si të papërshtatshme në kuptim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk mund të konsiderohen apriori se kanë cënuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

⁵ Vendim nr.41/2022; vendim nr.42/2022; vendim nr.21/2020

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Për sa më sipër, duke konsideruar se subjekti ka rezultuar se ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, së bashku me konkluzionin e arritur për një nivel të besueshëm në kriterin e kontrollit të figurës, arrij në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 59, pika 1, germat “a”, “b”, “c” të ligjit nr. 84/2016 dhe, në këto rrethana, ajo duhet të konfirmohet në detyrë.

Kryesuese

Pamela QIRKO